



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/30

Datë: 24.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 80 të Ligjit Nr. 06/L- 026 për Azil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/26 të datës 16.08.2021 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/28 të datës 21.08.2021 për ofrimin e mbrojtjes së përkohshme dhe të menjëhershme personave të rrezikuar nga konflikti i brendshëm në Afganistan, si në vijim:
2. Personat, subjekt i mbrojtjes nga pika 1. e këtij vendimi, janë personat në proces të aplikimit për Special Immigrant Visa (SIV) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, personat e kualifikuar në nën grupin P2 (klasifikim i veçantë i përcaktuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan si Priority 2), si dhe personat e tjerë të identifikuar, në bazë të marrëveshjes me SHBA-në, të cilët do të zhvendosen në SHBA apo në një shtet tjetër të tretë, përfshirë familjarët e këtyre grupeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë